



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 9.7.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10006, DATË 23.10.2008,
“PËR MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR”, TË NDRYSHUAR

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”, në mbledhjen e datës 9 korrik 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Besnik Baraj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit, mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Qëllimi i Projektligjit është propozimi i disa ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”, me qëllim që të adresohen ndryshimet e ndodhura si rezultat i reformës territoriale, ndryshimet në menaxhimin e pyjeve dhe organeve respektive të shërbimit pyjor në nivel vendor, të vitit 2016.

Gjithashtu, ndryshimet synojnë të transpozojnë dy direktiva të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës, direktivën nr. 92/43/EEC “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër”, të ndryshuar, dhe direktivën nr. 2009/147/EC, “Për konservimin e shpendëve të egër”, duke synuar një nivel të lartë përputhshmërie, rreth 95%.

Projektligji është hartuar me asistencën e projektit GEF/UNDP për sistemin e monitorimit mjedisor, dhe bazohet në modelin e shteteve anëtare të BE-së. Gjatë fazës së hartimit ai i është nënshtruar një konsultimi të gjerë me ekspertët e projektit, OJF dhe ekspertë të fushës së mbrojtjes së natyrës.

Ndryshimet që propozon projektligji konsistojnë kryesisht në:

- Ndryshimin e titullit të ligjit, me qëllim përfshirjen e termit konservim, në përputhje me frymën e direktivave;
- Reflektimin e ndryshimeve institucionale dhe transferimi i kompetencave që janë bërë gjatë kësaj periudhe;
- Ndryshimin e qëllimit dhe fushës së zbatimit të ligjit;
- Ndryshimin e përkufizimeve;
- Ngritjen e Këshillit Kombëtar të Faunës së Egër, si një strukturë me disa attribute këshillimore, që parashikohet të kontribuojë në lehtësimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore të tij.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 21 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Ky projektligj është përafuar pjesërisht me direktivën nr. 92/43/EEC, “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër”, të ndryshuar, nr. Celex 01992L0043-20070101, publikuar në “Fletoren zyrtare” nr. 206, datë 22.7.1992, si dhe është përafuar pjesërisht me direktivën 2009/147/EC “Për konservimin e shpendëve të egër”, nr. Celex 32009L0147, publikuar në “Fletoren zyrtare” nr. 20, datë 26.1.2010, faqe 7-25..

Plani Kombëtar për Integrimin European 2018-2020

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjikë dhe prioritetet e parashikuara në **Kapitulli 27: Mjedisi** të Planit Kombëtar për Integrimin European (**PKIE**) 2019-2020.

1. Aspektet Procedurale të përafrimit

- Neni 70 i MSA-së njih rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit European;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. Aspektet materiale të përafrimit

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit European (TFBE): Titulli II “Dispozita me zbatim të përgjithshëm”, **neni 11** (ish-neni 6 TKE); Titulli XX “Mjedisi”, **nenet 191-193** (ish-nenet 174-176 TKE).
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Titulli VIII “Politikat e bashkëpunimit”, **neni 108 “Mjedisi”**.

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- **Direktiva e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 Maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër”, e ndryshuar**.

Direktiva 2009/147/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 30 Nëntor 2009 “Për ruajtjen e shpendëve të egër”, e ndryshuar

Niveli i Përafrimit: I pjesshëm

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

- ***Diskutimi në Komision***

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komision deputetët vlerësuan nismën e propozuar dhe kërkuan shpjegime nga propozuesit lidhur me nevojën e kryerjes së ndryshimeve, me procesin e konsultimit publik, me përfshirjen e institucioneve dhe ekspertëve nga bota akademike, me procesin e inventarizimit/censit të faunës etj.

Relatori ngriti disa problematika të konstatuara, siç janë ato që lidhen me formën e projektligjit, duke argumentuar se projektligji bën ndryshime të shumta në ligjin ekzistues, duke nisur që nga titulli, qëllimi, fusha e zbatimit, përkufizimet dhe një numër i konsiderueshëm nenesh, si dhe u ndal në aspekte të teknikës legislative.

Në shpjegimet e tyre, përfaqësuesit e ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, u shprehën se procesi i hartimit të projektligjit daton rreth dy vite më parë, kur filloi puna për transpozimin e direktivave. Ky proces ka qenë i gjatë dhe gjithëpërfshirës. Në grupet e punës të krijuara për këtë qëllim ka pasur në përbërje edhe specialistë të fushës, të botës akademike, pedagogë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Universitetit Bujqësor.

Ndryshimet e propozuara synojnë një përafrim të pjesshëm të dy direktivave të BE-së, por shkalla e përafrimit është e lartë, rreth 95%. Gjithashtu, këto ndryshime janë në harmoni dhe referojnë edhe në legjislacionin e ri për zonat e mbrojtura, ligjin nr. 81/2017.

Procesi i inventarizimit të llojeve të faunës së egër në Shqipëri është një proces i vazhdueshëm që kryhet tashmë prej katër vitesh dhe në të marrin pjesë edhe pedagogët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

- ***Ndryshime të projektaktit***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me unanimitet, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni, pasi u njoh edhe me raportin e Komisionit Parlamentar për Integrimin European, u shpreh dakord me propozimet e paraqitura prej tij, duke i bërë pjesë të vërejtjeve të tij si më poshtë:

1. Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 92/43/KEE, datë 21 Maj 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31992L0043, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr. 206, datë 22.7.1992, fq.7-50.
- Direktivën 2009/147/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 30 Nëntor 2009 “Për konservimin e shpendëve të egër”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32009L0147, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.20, datë 26.1.2010, fq.7-25.

2. Në nenin 2, në pikën 1, të hiqet shprehja “përfshijet nenin 45, në të cilin përcaktohet ndryshe”.

3. Në nenin 4, të bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në pikën 2:

a. pika 2/1 të riformulohet:

“2/1. “Zonë” është një hapësirë e përcaktuar gjeografike, shtrirja e së cilës përshkruhet me hollësi” në aktin e shpalljes së saj si e tillë.”

b. pika 2/2 të riformulohet:

“2/2. “Statusi i ruajtjes së një lloji, ekosistemi, habitati **natyror** apo peizazhi” është gjendja e popullatave të llojit, ekosistemit, habitatit **nayror** ose peizazhit, që vjen nga tërësia e faktorëve që veprojnë mbi to.”.

4. Në pikën 5, përmbajtja e pikës 18 që shtohet, të riformulohet si vijon:

“18. “Komisioni” është Komisioni European.”.

5. Në nenin 7 të projektligjit, që shton nenin 6/1 në ligj, të bëhen ndryshimet si vijon:

6. Pika 2, të riformulohet:

“2. Çdo plan ose projekt që nuk lidhet drejtpërdrejt, por mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në zonën me interes për komunitetin evropian, i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Autoritetet kompetente, sipas përcaktimit në legjislacionin për zonat e mbrojtura, miratojnë planin ose projektin, në kuadër të

programit qeverisës, vetëm pasi të konstatohet, në raportin e vlerësimit të ndikimit për zonën dhe llojet, se ai nuk do të ndikojë negativisht në integritetin e zonës në fjalë dhe vetëm pas marrjes së mendimit të publikut.”.

7. Pika 3 të riformulohet:

“3. Në rastet kur një plan apo projekt duhet të realizohet për arsye të interesit publik, pavarësisht ndikimit negativ në zonën e llojet dhe në mungesë të zgjidhjeve alternative, miratohen masa kompensuese, sipas përcaktimeve në këtë ligj. Këto masa përcaktohen me urdhër të ministrit, me qëllim sigurimin e koherencës së përgjithshme të rrjetit të zonave me interes për komunitetin evropian.”.

8. Në nenin 8 të projektligjit, në pikën 3, që shtohet në nenin 7 të ligjit, shprehja “qeverisjen qendrore” të zëvendësohet më shprehjen “ministritë e linjës dhe/ose agjencitë ligjzbatuese”.

9. Në nenin 9 të projektligjit, përmbajtja e pikës 4 që shtohet në nenin 8 të ligjit, të riformulohet si vijon:

“4. Për ekosistemet, habitatet si dhe për llojet e faunës së egër me status mbrojtjeje, që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, në zona të caktuara mjedisore, sipas hartës së përhapjes së llojit dhe në pyjet e kullotat në administrim të njësisë së qeverisjes vendore, hartohen plane menaxhimi, që miratohen me urdhër të ministrit.”.

10. Në nenin 15 të projektligjit, shprehja “me kuadrin nënligjor që lidhet me”, të zëvendësohet me shprehjen” me Vendimin e Këshillit të Ministrave për”.

RELATOR

KRYETAR

Besnik BARAJ

Niko PELESHI